



Republika e Shqipërisë  
MINISTRIA E FINANCAVE

DOGANA  
CUSTOMS



Nr. 11634 datë 17-06-2022

Nr. 650 datë 17.06.2022

## PROTOKOLL

### “PËR NJOHJEN E PLUMBÇEVE/ PLLOMBAVE DHE VEPRIMEVE LIDHUR ME TO”

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Republikës së Shqipërisë dhe Drejtoria e Doganave e Republikës së Kosovës më poshtë referuar si “Palët”,

Bazuar në pikën 2 të nenit 1, pikën 8 të nenit 3, pikën 1 dhe 3 të nenit 5, të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për Zbatimin e Lehtësirave të Ndërsjella në Procedurat Doganore dhe/ose të Kontrollit të Hyrje-Daljes së Mallrave”, nënshkruar më 26.11.2021.

Mbështetur në Vendimin nr. 09/76, të datës 21.11.2018, të Qeverisë së Kosovës dhe Vendimit Nr.710, datë 23.11.2018 të Këshillit të Ministrave të RSH;

Mbështetur në Manualin e Përbashkët “Për procedurat e transitit në Zyrën e Doganës së Kosovës Pranë Portit Detar Durrës” (nr. 21328, prot., dt. 25.11.2021, Dogana e Shqipërisë dhe nr. 01/1723/20221, prot., dt. 25.11.2021, Dogana e Kosovës);

Me synim, zbatimin e lehtësirave dhe thjeshtimeve në procedurat doganore dhe/ose masave në lidhje me kontrollin në qarkullimin e mallrave ndërmjet dy vendeve;

Kanë rënë dakord si më poshtë vijojnë:

### **Neni 1**

#### **Plumbosja si masë identifikuese**

1. Kur mallrat do të vendosen nën regjimin e transitit, zyra doganore e nisjes (DK/DPD) plumbos si më poshtë:
  - a) hapësirën që mban mallrat, kur mjetet e transportit ose kontejneri është i pranuar nga zyra doganore e nisjes (DK/DPD) si i përshtatshëm për plumbosje.
  - b) çdo paketim individual, në raste të tjera.
2. Zyra doganore kompetente (DK/DPD) do të regjistrojë plumbçet/plombat në modulën elektronik të sistemit Assycuda sipas manualeve përkatëse.

### **Neni 2**

#### **Karakteristikat e plumbçeve doganore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës**

1. Plumbçet doganore të RSH dhe RK duhet t'i plotësojnë së paku specifikimet teknike si vijon:
  - a) forma dhe përmasat e plumbçeve mund të ndryshojnë në varësi të plumbosjes, por përmasat duhet të jenë të tilla që të garantojnë një tregues identifikimi lehtësisht të lexueshëm;
  - b) treguesit identifikues të plumbçeve duhet të jenë të pafalsifikueshëm dhe vështirësisht të riprodhueshëm;
  - c) materiali i përdorur të jetë rezistent ndaj thyerjeve aksidentale si dhe i tillë që të parandalojë falsifikimin ose ripërdorimin.
2. Plumbçet e certifikuar nga një organ kompetent në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO 17712:2013 "kontejnerë për transportin e mallrave - plumbçe mekanike", konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2. Për transportet me kontejner, do të përdoren plumbçe me elementë të lartë të sigurisë, në masën më të gjerë të mundshme.
3. Plumbçja doganore të Republikës së Shqipërisë duhet të mbajë treguesit e mëposhtëm:
  - a) fjalën "Dogana";
  - b) kodin shqiptar 'AL' e shtetit, në përputhje me standardet ISO-alpha-2;
  - c) simbolin e flamurit shqiptar (jo detyrues).
4. Plumbçja doganore të Republikës së Kosovës duhet të mbajë treguesit e mëposhtëm:
  - a) fjalën "Dogana e Kosovës";

- b) simbolin e Doganës së Kosovës;
- c) shifrën identifikuese të Plumbçes.

### Neni 3

#### **Autorizimi për përdorimin e plumbçeve të një lloji të veçantë**

1. Autoritetet doganore (DK/DPD) informojnë njëra tjetrën kur ato kanë miratuar Autorizime, për përdorimin e plumbçeve/pllombace të një lloji të veçantë për mjetet e transportit, kontejnerët ose pakot që përdoren nën regjimin e transitit.
2. Autoriteti doganor kompetent (DK/DPD) mund të mos pranojë plumbçe të një lloji të veçantë kur ka informacion se këto plumbçe të veçanta nuk janë të përshtatshme për qëllime doganore.

### Neni 4

#### **Masa identifikuese alternative për plumbosjen**

1. Zyra doganore e nisjes (DK/DPD) mund të vendosë të mos plumbosë mallrat nën regjimin e transitit por të mbështetet në përshkrimin e mallrave në deklaratën e transitit apo në dokumentet plotësuese, me kusht që përshkrimi të jetë mjaftueshmërisht i saktë, në mënyrë që të lejojë identifikimin e mallrave lehtësisht, të përcaktojë sasinë dhe natyrën e tyre si dhe karakteristikat e veçanta sikundër numrat serial të mallrave.
2. Përveç se kur zyra doganore e nisjes (DK/DPD) vendos ndryshe, as mjete i transportit, dhe as paketimet individuale që përmbajnë mallra nuk do të plumbosen nëse:
  - a) mallrat transportohen në rrugë ajrore, dhe çdo ngarkese i ngjiten etiketa që përmbajnë numrin e faturës shoqëruese të avionit (AËB), ose dërgesa përbën një njësi ngarkese mbi të cilën tregohet numri i faturës shoqëruese të avionit;
  - b) mallrat transportohen në rrugë hekurudhore dhe masat identifikuese zbatohen nga kompanitë hekurudhore.

### Neni 5

#### **Heqja e plumbçeve me qëllim kryerjen e një kontrolli doganor**

Sa herë që duhet të hiqet një plumbçe/pllombë me qëllim kryerjen e një kontrolli doganor, autoritetet doganore (DK/DPD) duhet të kryejnë riplumbosjen në mënyrën e duhur, me plumbçe/pllomba doganore dhe të shënojnë detajet e veprimeve të kryera në dokumentacionin e ngarkesës, përfshirë edhe numrin e ri të plumbçes/pllombës.


Bërë në Kukës (Morinë), më 17 qershor 2022, në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.




PËR  
DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË DOGANAVE TË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

PËR  
DOGANËN E REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

  
Genti Gazheli

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

  
Agron Llugaliu